



REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ · OPŠTINA OBILIĆ · MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-29563-24

Nr. i fq. Ër str. : No. pg.

Data : Datum : Date 30.09.2024

OBILIQ · OBILIĆ · OBILIC



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
**OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC**

**KUVENDI KOMUNAL OBILIQ**  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008) Ligjit Nr 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Ligjit Nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit Nr. 06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme sipas Neni 39 /A Shkalla tatimore tranzitore dhe Neni 83 pika 19 të Statutit të Komunës Nr; I -34 të dt 25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullorës së Punës së Kuvendit Komunal pas shqyrtimit të propozim vendimit nr.04-104-02-28024-24 e dt.18.09.2024. Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur më 26.09.2024 mori këtë:

**VENDIM**

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025

**Neni 1**

**Shkalla tatimore progresive**

1. Caktohen normat tatimore për vitin 2025 për të gjitha vlerat e pronave në territorin e Komunës së Obiliqit, sipas vlerës së kombinuar të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit, si vijon:

- 1.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.10 %**;
- 1.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.20%**, plus tatimi nga nën-paragrafi 1.1 të këtij neni;
- 1.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.30 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni;
- 1.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.40 %**, plus tatimi nga nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni; dhe
- 1.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.50%**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

2. Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform nenit 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

**Neni 2  
Zbatimi**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.


**Neni 3**

Ky vendim shfuqizon vendimin Nr.- I-156 te datës ; 30.11.2023

**Neni 4  
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyren e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës, dhe do të fillojë së zbatuari nga data 01 Janar 2025

- T'i dërgohet
- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- MAPL
- DAP
- Arkivit



Kryesuese e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi